

Gjuhë gjermane II

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Filologjisë, Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane
Titulli i lëndës:	Gjuhë gjermane II
Niveli:	BA
Statusi i lëndës:	I obligueshëm
Viti i studimeve:	Viti i I-rë Semestri i II-të
Numri i orëve në javë:	2+4
Kreditë ECTS:	6 ECTS
Koha / Vendi:	Sipas orarit të shpallur
Mësimdhënësi:	Prof.asoc.dr. Sadije Rexhepi
Të dhënat kontaktuese:	sadije.rexhepi@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës:	<p>Lënda zhvillohet në vazhdimësi të lëndës “Gjuhë gjermane I” dhe synon zhvillimin e shkathtësive komunikative dhe sociale të nevojshme për komunikim në një gjuhë: të shkruarit, të lexuarit, të folurit dhe të dëgjuarit; përvetësimin e njohurive për strukturën e gjuhës; sensibilizimin për aspektet ndërkulturore. Ushtrohen strategji të ndryshme të të lexuarit (global, selektiv e të detajuar), fjalori zgjerohet me shprehje më komplekse të nivelit B1. Gjatë ligjëratave trajtohen struktura gramatikore në nivelin B1; ushtrohen shkathtësitë produktive (tiparet e llojeve të ndryshme të teksteve, të folurit) dhe ato receptive. Të katër shkathtësitë do të ushtrohen përmes trajtimit të temave ndryshme. Njëkohësisht bëhet pasurimi i fjalorit të studentëve me fjalë e konstrukte fjalish që përdoren gjatë komunikimit. Për zhvillimin e mësimin do të përdoren krahas teksteve nga libri bazë edhe tekste autentike që ndërlidhen me përditshmërinë, gramatikat e gjuhës gjermane për të huaj, CD-të për ushtrimin e shkathtësisë së të dëgjuarit, etj.</p>

Qëllimet e lëndës:

Qëllimet kryesore të kësaj lënde janë:

- zhvillimi i shkathtësive receptive dhe produktive të studentit në nivelin B1 të Kornizës së Përbashkët Evropiane;
- t'i mundësohet studentit të bëhet përdorues eficient dhe fleksibil i gjuhës gjermane si për qëllime personale ashtu edhe për ato profesionale;
- të ngrisë vetëbesimin e studentëve dhe aftësinë e tyre për të komunikuar me folësit burimorë dhe joburimorë të gjermanishtes;
- të zhvillojë shkathtësitë studiuuese të studentëve dhe shkathtësitë për mësimin e gjuhës;
- t'i aftësojë studentët të kombinojnë gjuhën me shkathtësitë reale jetësore;
- të inkurajohet mësimnxënia e pavarur.

Rezultatet e pritshme të nxënies:

Pas përfundimit të këtij kursi studenti do të jetë në gjendje që të:

- komunikojë më lirshëm dhe pa gabime në gjuhën gjermane, në përputhje me nivelin e mesëm B1
- shkruajë tekste të ndryshme, mundësisht duke iu përmbajtur rregullave të drejtshkrimit dhe të strukturës së fjalisë së gjuhës gjermane,
- lexojë drejt duke iu përmbajtur rregullave të drejtshqiptimit të gjuhës gjermane, si dhe të kuptojë tekstet e lexuara,
- interpretojë temat dhe tekstet e caktuara të dëgjuara në gjuhën gjermane,
- zgjerojë leksikun e tij në përputhje me leksikun që është përdorur në librin bazë,
- aplikojë gjatë komunikimit gramatikën e trajtuar në librin bazë.

Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatet e nxënies së studentit)

Aktiviteti

Orë mësimore

Ditë/Javë

Gjithsej

Ligjëratat	2	15	22.5
Teori/Punë në laborator/Ushtrime	4	15	45
Punë praktike			
Përgatitje për test intermediar			
Konsultime me mësimdhënësin	15 min.	15	4
Puna në terren			
Testi, punimi i seminarit			
Detyrë shtëpie	2	15	30
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	2	15	30
Përgatitja për provimin final	5	2	10
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	2	2	4
Projektet, prezantimet, etj.			
Total			145.5 orë: 25 = 5.82 6 ECTS
Metodat e mësimdhënies:	Lënda realizohet përmes ligjëratave dhe ushtrimeve gjuhësore. Në orët e ushtrimeve punohet në përmirësimin e të dëgjuarit, të folurit, të shkruarit, të lexuarit; gramatikës e vokabularit. Përmes metodës bashkëbiseduese – punohet në mënyrë individuale, në çifte dhe në grupe.		
Metodat e vlerësimit:	Kufiri i kalueshmërisë së lëndës është 50%. Vijueshmëria e studentit dhe detyrat individuale të kryera në klasë dhe në shtëpi 10%; Vlerësimi nga testi I 45%; Vlerësimi nga testi final 45%.		
Literatura primare:	1. Koithan, U / Schmitz, H. / Sieber, T. / Sonntag. 2014. Aspekte neu B1 plus, Langenscheidt. München. 2. Mayr-Sieber, Tanja. 2017. Aspekte neu B1 plus bis C1. Mittelstufe Deutsch Grammatik. Ernst Klett Sprachen, Stuttgart.		
Literatura shtesë:	1. Duden 4. 2022. Die Grammatik. Berlin. 2. Dreyer/Schmitt 2021. <i>Lehr- und Übungsbuch der deutschen Grammatik</i> , Neubearbeitung: 'Die neue Gelbe'. Ismaning/München 3. Helbig/Buscha. 2013. <i>Übungsgrammatik</i> . Leipzig. 4. Hall / Schneider. 2001. <i>Übungsgrammatik für Fortgeschrittene DaF</i> . 5. Duden. (2009): <i>Fit für das Bachelorstudium</i> . Mannheim.		

Hartimi i planit mësimor

Java	Titulli i ligjëratës
Java 1:	Lektion 6: Zukünftiges und Vermutungen ausdrücken (Futur I und Präsens)
Java 2:	Lektion 6: Verben mit Präpositionen und Pronominaladverbien
Java 3:	Lektion 7: Reflexive Verben
Java 4:	Lektion 7: Relativsätze
Java 5:	Lektion 8: Finalsätze
Java 6:	Testi gjysëmsemestral
Java 7:	Lektion 8: Konjunktiv II (Formen)
Java 8:	Lektion 8: Konjunktiv II (Verwendung)
Java 9:	Lektion 9: Konnektoren; Temporalsätze
Java 10:	Lektion 9: Temporale Präpositionen
Java 11:	Lektion 10: Passiv
Java 12:	Lektion 10: Passiversatzformen, Passiv mit Modalverb
Java 13:	Lektion 10: Lokale Präpositionen
Java 14:	Lektion 10: Lokale Präpositionen (mit Wechselpräpositionen)
Java 15:	Testi final

Politikat akademike dhe kodi i sjelljes

Për të fituar të drejtën për të hyrë në teste dhe provim, studentët janë të obliguar t'i vijnë ligjëratat dhe ushtrimet. Nuk tolerohen më shumë se tri mungesa gjatë semestrit. Detyrat që dalin nga këto orë mësimi janë të obligueshme dhe pjesë e vlerësimit të përgjithshëm të studentit. Plagjiatura dhe kopjimi në provime dhe punimet e tjera me shkrim janë të dënueshme. Në rastet e tilla studenti i nënshtrohet masave disiplinore, siç parashihet me rregulloret e UP-së. Telefonat mobil/të mençur dhe pajisjet e tjera elektronike duhet të fikën (apo të jenë pa zë) dhe të mos ekspozohen gjatë orëve të mësimi.